

# GJUHA SHQIPE-GJUHA E ZOTIT DHE E ROBIT, U RUAJTË EDHE NË MEDVEGJË

Prof. Rexhep ABAZI, Medvegjë

**“Gjuha jonë sa e mirë!  
Sa e ëmbël, sa e gjerë!  
Sa e lehtë, sa e lirë!  
Sa e bukur, sa e vlerë!”**

**Naim frashëri**

Gjuha si mjet komunikimi dhe njëri nga elementët që njeriun e bën të dalluar nga qëniet e tjera të gjalla është zhvilluar krahas me vet njeriun. Ajo është elementi më i rëndësishëm i kombit dhe shtetit. Mbase edhe shqiptarët si pasardhës iliro-dardanë patën, kanë dhe do kenë gjuhën e vet amtare dhe kombëtare, gjuhën shqipe e cila në ditët e sotme ka arritur shkallën më të lartë të zhvillimit të saj. Hulumtimet dhe studimet e parreshtura të gjuhëtarëve, historianëve, sociologëve e shkencëtarëve të tjerë kanë bërë zbulime të vlerëshme shkencore të cilat na tregojnë se gjuha shqipe është ndër gjuhët më të vjetra të Evropës. Në rrethana dhe kushte të ndryshme, shpesh edhe me sakrificë të mëdha, gjuha shqipe ia doli të mbijetojë sfidat e shumta e rreziqet e papara, por ia doli të ekzistojë e të përballojë çdo fortunë e sulme dashakeqe nga shumë armiqtë të saj. Kjo gjuhë e ëmbël dhe e shenjtë u ruajt, u zhvillua dhe u kultivua brez pas brezi e kohë pas kohe, me një kulturë të lashtë e të denjë kombëtare shqiptare. Mbase, dijetarët shqiptarë, më 14-22 nëntor të vitit 1908, në qytetin e Manastirit mbajtën Kongresin për të përcaktuar alfabetin e gjuhës shqipe, të ftuar nga shoqëria më aktive e asaj kohe “Bashkimi” e Manastirit, për diskutimin e një alfabeti të njësuar të gjuhës shqipe. Në këtë Kongres morrën pjesë 160 pjesmarrës nga e gjithë Shqipëria dhe pjesët e tjera të trojeve shqiptare, por edhe nga komunitetet shqiptare në Amerikë, Rumani, Egjypt, Turqi, Itali, Greqi etj. Kryetar i kongresit ishte zgjedhur Gjergj Fishta, nga Shkodra, nënkryetar Grigor Cika, nga Korça, sekretare e komisionit Parashqevi Qiriazi, mësuese e shkollës së vashave në Korçë si edhe njëmbëdhjetë anëtarë të kongresit. Në Kongres morrën pjesë shqiptarë të të gjitha konfesionëve, njerëz të ditur të ardhur këtu për një qëllim të përbashkët e madhështor kombëtar. Kongresi, me votë unanime, vendosi për alfabetin me 36 shkronja, i cili alfabet përdoret tani e 112 vjet.

Ndoshta, Ndre Mjeda i thuri vargjet më të bukura për gjuhën shqipe:

....”Përmbi za, që lëshon bylbyli,

Gjuha shqipe m’shungullon....”

Sot, kur festojmë 112 vjetorin e këtij kongresi, duhet t’iu jemi mirënjohës atyre veprimtarëve e dijetarëve të mëdhenj që na krijuan e na lane në trashigimi një alfabet me të cilin gjuha shqipe shkroi historinë, kulturën, të shkuarën dhe të tanishmen e saj. Andaj, motra e vëllezër Lavdi e përjetshme për të gjithë pjesmarrësit e Kongresit për krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe.

Unë në punimin tim do të përqëndrohem në temën:

**RUAJTJA, ZHVILLIMI DHE KULTIVIMI I GJUHËS SHQIPE NË TROJET SHQIPTARE TË MEDVEGJËS**

Pse?

Sepse kjo pjesë e trojeve shqiptare është rajoni më i rrezikuar dhe më i sfiduar i tokave shqiptare. Medvegja, përkatësisht Presheva, Medvegja e Bujanoci hë për hë, dhe në vazhdimësi janë toka shqiptare që janë nën ingerencat e Republikës së Serbisë e cila nuk tregoi as nuk po tregon as njëhere interesim për mirëqenie dhe zhvillim të këtij rajoni, pikërisht për shkakun se është i banuar me shqiptarë. Në situatën më të rëndë, por besoj jo edhe të pashpresë, gjendet vet Medvegja, e cila është pjesa e vetme e tokave shqiptare e mbetur nën Serbi pas egzodit e gjenocidit të bërë ndaj shqiptarëve të Sanxhakut të Nishit, Leskocit, Vrajës, Prokupjes, Kurshumlisë etj., në vitin 1878.

## **SHQIPTARËT E MEDVEGJËS U SHKËPUTËN NGA TRUNGU I TOKËS AMË**

Në fundvitin 1977 dhe fillimvitin e vitit 1878 shteti Serb ndërmorri fushatë spatriimi etnik të shqiptarëve të jugut të Serbisë i cili arriti përmasa gjenocidi. Nga sanxhaku i Nishit, Leskocit, Vrajës, Prokupjes, Kurshumlisë etj., forcat ushtarake e militare të Serbisë bënë spatriimin e popullatës shqiptare me metodat më çnjerëzore duke vrarë, prerë e masakruar popullatën e pafajshme e të pambrojtur shqiptare, nga 740 vendbanime shqiptare (sipas historianit Dr. Sabit Uka, Prishtinë). Ishte kohë dimri me dëborë të madhe e acar, ku ata që u nisën në rrugë pakthim duke tentuar të shpëtojnë familjet, gjatë rrugës shumë nga këta gjetën vdekjen nga i ftohti i madh. Sipas gojëdhënave të ruajtura brez pas brezi, ka patur raste kur nënave të lodhura e të rraskapitura nga rrugëtimi i rëndë u kanë rënë foshnjat nga krahu dhe kanë gjetur vdekjen në dëborën e ftohtë. Ishte ky një tmerr i paparë të cilin ia shkaktoi Serbia kombit shqiptar.

## **SHQIPTARËT E MEDVEGJËS E RUAJTËN TOKËN, GJUHËN DHE KULTURËN SHQIPTARE**

Nga kjo katrahurë e rëndë, Zoti e di përse, në komunën e Medvegjës nën regjimin e Serbisë mbetën dymbëdhjetë vendbanime shqiptare, të cilat edhe sot janë kështu, pa u dëbuar në atë kohë. Si dhe pse mbeti kjo pjesë e kombit shqiptar pa u dëbuar nga trojet e tyre nuk dihet, por si do që të jetë në trojet e veta shekullore mbetën këta pak shqiptarë për të hequr të zitë e ullirit në mbijetesën e tyre. Shteti serb nuk ua ndau zullumin në vazhdimësi, duke i patur në shënjestër për çdo rast kur i nevojitej t'i paraqiste shqiptarët si njerëz të pacivilizuar, e në veçanti si armiq të shtetit serb. Nga kjo shumë shqiptarë në më shumë se një shekull u vranë me hir e pahir, me qëllim e pa qëllim, e të gjithë pa kurfar faji, vetëm pse ishin shqiptarë. Por, shqiptarët e Medvegjës, me heroizëm, me stoicizëm, me sacrificë e vendosmëri, me jetën e tyre, me gjakun e tyre e me luftën titanike ia dolën që në këto toka deri në ditët e sotme të flitet e të jetohet shqip. Planet e nacionalistëve serbë për spastrimin e shqiptarëve nga këto troje (i Qubrilloviqit, Garashaninit, Pashiqit, Millosheviqit), por fatkeqësisht të miratuara dhe jetësuara nga organet e larta shtetërore nuk pushuan kurrë, prandaj këto toka gjithmonë u vaditën me gjakun e freskët shqiptar. Mbase, në vuajtjet titanike shqiptarët nuk i braktisën këto troje, nuk e braktisën kulturën, historinë e në veçanti nuk e harruan gjuhën e nënës shqipe. Në kohën e Mbretërisë së Serbisë këta shqiptarë nuk gëzonin kurfarë të derjetash njerëzore, as ato elementare, e të mos flasim për shkolla e institucione të tjera të kulturës. Deklarativisht në ish RSFJ-n thuhej se të gjithë njerëzit dhe qytetarët janë të barabartë, por fatkeqësisht, kjo për shqiptarët nuk u realizua kurrë.

## **SI U RUAJT DHE U ZHVILLUA GJUHA SHQIPE E KËTYRE TROJEVE**

Dashuria e madhe ndaj kombit e atdheut dhe shpresa se një ditë edhe kjo pjesë do i bashkohet trungut shqiptar, e që fatkeqësisht kjo nuk ndodhi as pas mbi njëqind e dyzet e tre vjetësh (143), shqiptarët e Medvegjës i bëri edhe më të vendosur e më të qëndrueshëm që të ruajnë vendin dhe gjuhën e vet. Historia, kultura e gjuha u ruajtën brez pas brezi duke iu falënderuar nënës shqiptare, familjes shqiptare

me tradita të forta kombëtare të shqiptarëve të Medvegjës. Është shumë indikative, që edhe pse të rrethuar e të ndikuar nga kushtet e forta për asimilim, asnjëherë e në asnjë kohë nuk pati shqiptarë të asimiluar, të konvertuar apo edhe të martuar me pjestarë të popullatës serbe. Nuk u shënuar asnjë rast i martesës së djalit apo vajzës shqiptare me serb. Kështu u ruajt pastërtia kombëtare e fetare, e në veçanti u ruajt gjuha amëtare shqipe. Në trojet e Medvegjës u folë dhe flitet forma e dialektit tosk i Shqipërisë së veriut. Kjo gjuhë u fol, u ruajt dhe u zhvillua në formën më të pastër dhe të avancuar të saj. Nuk pati shkolla shqipe deri pas Luftës së Dytë Botërore, por gjuha shqipe u ruajt dhe u zhvillua në familje shqiptare. Oda ishte vendi me rëndësi në të cilën brez pas brezi e gjeneratë pas gjenerate ruhej e bartej kultura shqiptare, mbase edhe kultura e të folurit. Kënga epike ishte po kështu e një rëndësie të veçantë nëpërmjet së cilës bartej e ruhej gjuha shqipe, historia e kultura shqiptare. Në çdo shqëpi të shqiptarit ruhej lahuta, çitelia, kavalli e fyelli, me të cilat përcillej kënga, e me këngët e kaluara e lavdijshe por edhe e rëndë e hidhur e kombit shqiptar.

### **U PRITË QË LUFTA E DYTË BOTËRORE TË HAPË NJË DRITARE SHPRESE??!!**

Lufta e Dytë Botërore në këto troje u proklamua si luftë çlirimtare e luftë e cila do i jepte fund diskriminimit e padrejtësisë. Për këtë edhe një numër i shqiptarëve nga kjo trevë mori pjesë në këtë luftë. Diçka edhe ndryshoi nga e kaluara. Duke filluar nga viti 1946, në vendbanimet shqiptare u hapën shkolla fillore katër klasëshe, por me mësim në gjuhën serbe. Fatmirësisht më vonë këto shkolla u shndërruan në shkolla me mësim në gjuhën shqipe dhe kështu për këto treva filloi një epokë e re e jetës kulturore e kombëtare. Në fillim në këto shkolla punuan njerëz me kualifikime jo adekuate për mësues, por me dëshirë e vullnet të madh për kulturë, atdheun e kombin. Më vonë, pas viteve të gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar, kur në shkollat e mësuesisë në Kosovë u shkolluan kuadro të mësuesisë, mësimi në shkollat shqipe fitoi dimension të rinj dhe më kualitativ, kështu filloi të zhvillohet e kultivohet gjuha shqipe më mirë e më shumë. Duhet cekur se në mesin e mësuesëve të parë të shkollës shqipe në Medvegjë ishin: Osman Murati (I njohur në popull si Hoxha i Malës) nga Sfirca, Abaz Osmani, nga Sfirca, Shaban Xhema nga Tupalla. Këta ishin mësuesit e parë të shkollave shqipe në Medvegjë. Gjenerata e ardhshme e mësuesëve të shkollave shqipe ishin: Ramiz Muharremi nga Tupalla, Zeqir Jakupi, nga Dediqi, Ruhan Osmani, nga Sfirca, Bafti Krasniqi, nga Gërbaci, Aza Hajdari nga Siarina, Maliq Hajdari nga Gërbaci, Feti Jakupi nga Dediqi, Ukë Ismaili nga Tupalla.

Gjeneratë vijuese e mësuesëve të shkollave shqipe ishin: Naman Aliu, nga Kapiti, Zenel Sahiti nga Llapashtica, Halim Hyseni nga kapiti, Hamdi Ferati nga Siarina, Hysen Kadriu nga Tupalla, Ajet e Ruhan Ismajli nga Tupalla, Hasan Jashari, nga Sfirca, Ferat Hyseni, nga Gërbaci Miftar Sylja, nga Gërbaci, Ramiz Jakupi nga Dediqi, Sejdi Kosumi nga Kapiti, Xhemail Osmani nga Llapashtica, Rrahman Jakupi nga Dediqi, Mihrije Ajeti-Kadriu, nga Llapashtica. Gjenerata e mësuesëve shqiptarë që vazhduan misionin e shenjtë e të cilët ishin shkolluar në shkollat e mësuesisë në Kosovë të cilët iu kthyen vendlindjes janë edhe: Ramë Aliu nga Kapiti, Rexhep Abazi, nga Sfirca, Hajrullah Latifi, nga Gërbaci, Ramiz Avdili, nga Gërbaci, Nazmi Jashari nga Sfirca, Ramadan Jakupi, nga Dediqi, Rexhep Aliu, nga Kapiti, Miftar Mehmeti, nga Sfirca, Gani Krasniqi, nga Gërbaci, Latif Latifi, nga Gërbaci, Ramiz Zeqiri nga Sfirca, Abaz Abazi, nga Sfirca, Isuf Bejiq, nga Ramabaja, Ajshe Munishi-Sylejmani, nga Sfirca, Haki Azemi, nga Gërbaci, Nuriye Ajeti-Ferati, nga Llapashtica, Sabit Osmani, nga Llapashtica, Zejnullah Zeqiri, nga Tupalla, Ramiz Kadriu nga Tupalla. Pas kësaj periudhe në shkollat shqipe erdhën edhe shumë mësues të cilët dhanë kontribut të rëndësishëm në procesin edukativo-arsimor dhe në ruajtjen e zhvillimin e gjuhës shqipe. Moment i rëndësishëm në këto treva ishte edhe koha kur për ca vite u zhvillua një fazë e

mësimit të shkollave të mesme i quajtur mësimi i orientuar, në të cilin proces përveç kuadrove vendore, një kontribut të çmuar dhanë edhe profesor e mësime dhënë nga Kosova.

Drejtorë të shkollave shqipe në komunën e Medvegjës ishin: Ramiz Muharremi, nga Tupalla, Ruhan Osmani, nga Sfirca, Naman Aliu, nga Kapiti, Maliq Hajdari, nga Gërbaci, Rexhep Abazi, nga Sfirca, Ramadan jakupi nga Dediqi, Zejnullah Zeqiri, nga Tupalla. Në shkollën fillore në Bajë të Siarinës, drejtor shqiptar nuk ka që nga viti shkollor 1992/93, kurse në shkollën fillore në Tupallë që nga viti shkollor 2000/2001, regjimi i shtetit të Serbisë nuk lejon zgjedhje të drejtorit legjitim, sipas konkursit në shkollat shqipe, por këto i mban me Ushtrues të detyrës së drejtorit, deri në ditët e sotme. Edhe në këto ditë dhe në këto kohëra, kur shoqëria njerëzore dhe të arriturat e shkencës, teknikës e kulturës kanë arritur shkallën më të lartë të zhvillimit, në Medvegjë po mundohen të mbijetojnë shkollat shqipe, por me kushte e rrethana skajshmërisht të vështira. Situata kadrovike është në nivel brengosës, sepse kuadrot e kualifikuara mungojnë në një përqindje të madhe apo alarmante, dhe në mungesë të tyre, në procesin edukativo-arsimor punojnë njerëz pa kualifikime e përgatitje të duhura e adekuate shkollore. Shteti i Serbisë për këtë situatë nuk brengoset, madje këtë gjendje edhe e preferon si të mirëseardhur, e shtetet shqiptare, siç duket të ngarkuara me problemet e tyre, apo ndoshta edhe nga neglizhenca, për këtë pjesë të trojeve dhe situatën e popullatës shqiptare po angazhohen fare pak. Është për t'u përshëndetur nisma e këtij viti shkollor kur nga Shqipëria dhe Kosova u dërguan tekste shkollore të cilat shkollave shqipe në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc u mungonin që nga vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar. Por, kjo nuk mjafton, duhet ofruar ndihma materiale e kadrovike, për këto shkolla e këta njerëz të sakrificës së madhe e sublime.

Sepse, këto treva dhe nga këto treva shqiptare dolën njerëz të mëdhenj të cilët dhanë shumë, madje edhe jetën për kombin, për kulturën e shkollën shqipe. Padyshim se, njëri ndër këta ishte edhe Akademik Idriz Ajeti, nga Tupalla e medvegjës, albanologu i parë shqiptar i Dardanisë, mësuesi i madh i gjuhës shqipe, rektori i parë i Universitetit të Kosovës, Kryetari i Parë i Parlamentit të Republikës së Kosovës, Pjesmarrësi dhe i Kongresit për unifikimin e gjuhës shqipe të vitit 1972 në Tiranë, njeriu i cili një shekull të jetës së tij ia kushtoi gjuhës shqipe, shkollës shqipe e kulturës shqiptare. Dua të cek edhe një gjë, sipas meje me rëndësi për trevat e Medvegjës. Në këtë komunë deri në vitin shkollor 1969/70, në shkollat e venbanimeve shqiptare në: Starabajë e Ramabajë, mësimi për nxënësit shqiptarë u zhvillua në gjuhën serbe. Me kërkesat e pandërprera dhe të paluhatshme të popullatës shqiptare, e me vendimin e organeve kompetente të komunës së Medvegjës, për here të parë në vitin shkollor 1970/71 në Starabajë e Ramabajë u lejua të fillojë **mësimi në gjuhën shqipe për nxënësit shqiptarë**. Mësuesit e parë në shkollën shqipe ishin, në Starabajëishin: **Rexhep Abazi, nga Sfirca dhe në Ramabajë: Hajrullah Latifi, nga Gërbaci.**

Kështu, në këtë komunë u përmyll procesi i hapjes së shkollave shqipe për nxënësit shqiptarë në të gjitha vendbanimet shqiptare. Puna e palodhur, vetë mohuese e sakrificat e vazhdueshme të mësimit dhënë për shqiptarë, duke filluar që nga koha e pasluftës së Dytë botërore e deri në ditët e sotme rezultuan me një sukses të madh në ruajtjen e zhvillimin e gjuhës shqipe në këto treva. Padyshim që rëndësi të veçantë patën edhe hapja e dy shkollave tetëvjeçare në Bajë të Siarinës në vitin shkollor 1964/65 dhe asaj në Tupallë në vitin shkollor 1970/71, si edhe të ciklit të parë të shkollës së mesme në Medvegjë në vitin shkollor 1979/80. Falë popullit të vyeshëm e trim shqiptar, falë shkollave shqipe e punëtorëve të palodhur e guximtarë arsimorë, gjuha shqipe në trevat e Medvegjës u ruajt nga zhbërja dhe harresa dhe u kultivua me dashuri por edhe sukses të lartë. U ruajtën edhe më turje forma e dialektit gegë, e në shkolla gjuha e unisuar shqipe sipas Kongresit të Gjuhës shqipe të Tiranës, të vitit 1972.

## **KONTRIBUTI I SHKOLLAVE SHQIPE NË MEDVEGJË NË RUAJTJEN E GJUHËS SHQIPE**

Deri në hapjen e shkollave shqipe në rajonin e Medvegjës merita e ruajtjes dhe zhvillimit të gjuhës shqipe është e vetë popullit, e nënës dhe e familjes shqiptare e cila gjithmonë foli shqip dhe jetoj shqip. Padyshim që, kushtet dhe rrethanat e jetës së kësaj popullate shqiptare të shkëputur nga trangu amë dhe nën ndikimin e jetës në afërsi me serbët nuk pati mundësi t'i përballojë barbarizmat e gjuhës serbe, kështu që përkundër rezistencës së madhe, në gjuhën shqipe filluan të futen barbarizma të gjuhës serbe. Ndoshta, në momentin më kritik, dhe për fatin e mirë, hapen shkollat shqipe në vendbanimet e shqiptarëve të Medvegjës dhe në këtë mënyrë gjuha shqipe fillon luftën kundër futjes së barbarizmave serbe dhe largimin e atyre që ishin futur në gjuhën tonë. Nxënësit dhe mësuesit shqiptarë, nepërmjet shkollës shqipe e ruajtën gjuhën shqipe të pastër dhe të bukur. Tani më, duke i dëgjuar fëmijët e tyre, edhe prindërit por edhe ata që nuk kishin patur mundësinë të shkonin në shkollë, filluan të largonin përdorimin e barbarizmave nga gjuha shqipe. Shkollat shqipe dhe mësuesit shqiptarë të këtyre trevave kryen me dinjitet, përgjegjësi dhe guxim misionin e tyre të shenjtë duke krijuar kulturë gjuhësore për t'u lakmuar. Mbase, kjo plejadë e njerëzve të kombit mund të quhen edhe heronjë të punës edukativo-arsimore, të zhvilluar në kushte e rrethana tejet të vështira e shumë shpesh edhe të rrezikshme.